

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**Sot më datë 20.04.2024:**

- Xhenildo Methoxha, atësia Haxhi, shtetas Shqiptar, lindur më 15.07.1991, në Corovodë, Skrapar, Shqipëri, banuese në Vlorë me dokument ID nr. J10715005I.

bazuar, në legjislacionin në fuqi vecanërisht, bazuar në nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Ligji nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, në dispozitat e Kodit Civil në cilësinë e ortakut themelues si dhe në vullnetin tonë të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë shoqëria):

### **KREU I**

#### **THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

##### **NENI 1**

##### **DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT**

1. Sot ne date 20.04.2024 u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“Armando Speed Boat Adventure”**
2. Themeluesi i shoqerise eshte:
  - Xhenildo Methoxha, atesia Haxhi, shtetas Shqiptar, lindur me 15.07.1991, ne Corovode, Skrapar, Shqiperi, banuese ne Vlore me dokument ID nr. J10715005I.

##### **NENI 2**

#### **OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekt i kësaj shoqërie do të jetë:

1. Shërbime turistike, Guide turistike detare
2. Transport ujqor, turizëm familjar, turizëm detar
3. Shërbime turistike në det
4. Cdo aktivitet tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të aksionarit dhe mund të kryejë cdo lloj aktiviteti në përputhje me legjislacionin Shqiptarë.



Për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të përfshihet në themelimin e shoqërive të tjera me qëllime të njëjta ose të ngjashme, pavarësisht statusit të tyre ligjor dhe të marrë pjesë, të bashkëpunojë dhe përfaqësojnë biznese të tjera, cfarëdo qoftë statusi i tyre ligjor në Shqipëri ose jashtë vendit.

Për të gjitha aktivitetet që kërkojnë licenca të vecanta shoqëria do të angazhohet që tani për të plotësuar kërkesat e ligjeve të posacme.

### **NENI 3**

#### **KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë deri në një afat të papërcaktuar

Shoqëria mund të priset përpara këtij afati me Vendim të Asamblese së Ortakut.

### **NENI 4**

#### **SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Murat Terbaci, Lagjja 10 Korriku, Pallati i ndërtuar nga shoqëria “Europrogres”, Kati 7, Apartamenti 35, Vlorë

### **KREU II**

#### **KAPITALI**

### **NENI 5**

#### **KAPITALI I REGJISTRUAR**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë do të jetë 50.000 (pesëqind mijë ) lekë i përbërë nga një kuotë.

**Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është:**

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është 50.000 (pesëqind mijë) lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë nga

Ortaku:

- Xhenildo Methoxha, atësia Haxhi, shtetas Shqiptar, lindur më 15.07.1991, në Corovodë, Skrapar, Shqipëri, banuese në Vlorë me dokument ID nr. J10715005I.

Kontribuetet e ortakut mund të jenë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, apo të drejta).

## **NENI 6**

### **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit të regjistruar për kontribute në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e regjistrimit të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakut, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohej për ndryshimin e statutit.

Ne të gjitha rastet zvogelimi prek në të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **NENI 7**

### **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen si më poshtë:

- (a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- (b) Shitblerjes
- (c) Trashëgimis
- (d) Dhurimit
- (e) Cdo mënyrë tjetër përcaktuar në ligj

Pjesët e kapitalit të regjistruar janë të transferueshme me rrugë trashëgimije, sipas parashikimeve ligjore.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

## **NENI 8**

### **ORGANET VENDIMMARRESE**

Asambleja e Ortakut është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshtjet si më poshtë:

- (a) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë



- (b) Ndryshimet e statutit
- (c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- (d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- (e) Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat C) e D).
- (f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- (g) Miratimin i bilanceve
- (h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- (i) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- (j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- (k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- (l) Miratton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- (m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## **NENI 9**

### **THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsiwe.

## **NENI 10**

### **KUORUMI**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit” Per tregetaret dhe Shoqerite tregtare”, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te



votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperem nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## **NENI 11**

### **MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e pergjithshme vendos per ndryshimin e statusit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumice vote te ortakut pjesmarres, per ceshtje te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

## **NENI 12**

### **PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- (a) Vleresimin e veprimtarise se tij
- (b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- (c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- (d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortakut perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakut, te cilin perfaqeson.

## **NENI 13**

### **ADMINISTRIMI**

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë, duke patur të drejta të pakufizuara administrimi:

- Idrenit Dreni, atësia Halil, shtetas Shqiptare, lindur më 29.05.1990, në Kukës, Shqipëri, me dokument ID nr. J00529090C.



## NENI 14

### KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- (a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të vendosura nga asambleja e përgjithshme duke zbatuar politika tregtare
- (b) Përfaqësojnë shoqërinë
- (c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë
- (d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim
- (e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- (f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhëna të detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- (g) Raportojnë para Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe të veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë
- (h) Kryejnë detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe statute.

Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure apo autorizimi me afat të caktuar apo të pacaktuar, një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë dhe për të nënshkruar cdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë në përputhje me kompetencat që ka në këtë statut.

## NENI 15

### PERGJEGJESIA E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Administratorët të cilët kanë kryer veprime ose bërë marrëveshje të pa aprovuar nga asambleja, janë përgjegjës për dëmet e sjella shoqërore dhe përgjigjen personalisht ose solidarisht për pasojat.
2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar ti demshperbleje shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kalojë cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

## KREU IV



## **VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

### **NENI 16**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor, përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

### **NENI 17**

#### **EKSPERTET**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i garkuar nga ana e ortakëve.

Në përmbushje të kësaj detyre eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

### **KREU V**

#### **PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE**

### **NENI 18**

#### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- (a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar e shoqërisë
- (b) Me vendimet e asamblesë së ortakëve
- (c) Me hapjen e procedurave të falimentit
- (d) Nëse nuk zhvillon aktivitet tregtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- (e) Me vendim gjykate

### **NENI 19**

#### **RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

### **NENI 20**



## **LEGJISLACIONI**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 datë 14.04.2008: Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

### **NENI 21**

#### **MOSMARRREVESHJET**

Për mosmarrëveshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me të tretët, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky akt, u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe.

#### **ORTAKU I SHOQERISE**

**Xhenildo Methoxha**

Xhenildo Methoxha

